



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:006282

Datë: 23.02.2021

Numri i dokumentit: 01531315

P. nr. 15/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit D. D. nga Gjakova, për shkak të veprës falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP/II.nr.1586/20 e datës 18.01.2021, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **16.02.2021**, në prani të Prokurorit te shtetit Dëshire Jusaj dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli ndërsa përpiluar me datën 23.02.2021 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **D. D.** nga Gjakova „Rr”. . . (banesa sociale), data e lindjes . . . , në Gjakovë ,i biri i S. dhe i nënës Z. e gjinisë F. , ka te kryer shkollën mesme, punëtor , i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar ,shtetas R. Kosovës, i martuar atë i 4 fëmijëve , me ID . . .

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

-nga data e pavërtetuar e gjerë me datë 04.03.2020, rreth orës 13.30 min., në Rr “. . .” në Gjakovë , me dije ka përdorë dokumentin e falsifikuar dhe atë dokumentin publik –dëshmi aftësie (patentë shoferin) me nr. serik 903947, ku pasi i pandehuri ndalohet gjersa ishte duke e drejtuar veturën e tij ,pas prezantimit të patentë shoferit është dyshuar se dokumenti është falsifikuar , ku sipas urdhëresës se prokurorisë është siguri raporti i ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzik, , me nr. AFK/2020-1166/2020-962 i datës 23.06.2020 , nga i cili është konstatuar se patentë shoferi i lartcekur nuk është prodhuar sipas teknologjisë standarde të prodhimit , ka gabime gramatikore në drejtshkrim dhe se i njëjti është falsifikim i plotë dhe i njëjti është sekuestruar nga ana e Policisë.

- **me çka ka kryer veprë penale falsifikimi dokumenteve nga neni 390 par.2lidhur me par.1 të KPRK-së.**

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39, 46, 47, 48, 49,69 ,70, neni 390 par. 2-1të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **7(shtatë) muaj** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20,00 €**, në afat prej **15 ditëve** pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Gjykata ne kuptim te dispozitës 115 të KPPK-së, të akuzuarit i

Konfiskohet patentë shoferi i lëshuar nga Republika e Shqipërisë me nr. serik 903947, i sekuestrua me datën 04.03.2020, që është objekt i kësaj vepre penale .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1586/20 të datës 18.01.2021, e ka akuzuar të akuzuarin D. D. nga Gjakova, për shkak të veprës falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar me të datës 16.02.2021, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë , Prokurori Dëshire Jusaj , lexon aktakuzën PP/II.nr.1586/20 të datës 18.01.2021, ku deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari D. D. , gjatë shqyrtimit fillestar lidhur me fajësinë deklaroi se pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, me qenë se patentë shoferi të cilën e kam përdorë që nga viti 1989 ,më është sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor e cila ka rezultuar te jetë i falsifikuar , andaj me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për këtë vepër ,premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe do të jem më i kujdesshëm, andaj i propozoi gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, premtimi se në te ardhmen do të jem me i kujdesshëm dhe nuk do te përsërisë vepra te tilla apo te ngjashme , gjendjen e dobët ekonomike-jetë në banesa sociale , me familje prej 9 anëtarëve , si dhe fakti se është hera e parë qe kam ra ndesh me ligjin të më shqiptojë një dënim me te butë.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari D. D. : **-nga data e pavërtetuar e gjerë me datë 04.03.2020**, rreth orës 13.30 min., në Rr “Skënderbeu” në Gjakovë , me dije ka përdorë dokumentin e falsifikuar dhe atë dokumentin publik –dëshmi aftësie (patentë shoferin) me nr. serik 903947, ku pasi i pandehuri ndalohet gjersa ishte duke e drejtuar veturën e tij ,pas prezantimit të patentë shoferit është dyshuar se dokumenti është falsifikuar , ku sipas urdhëresës se prokurorisë është siguri raporti i ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzik , me nr. AFK/2020-1166/2020-962 i datës 23.06.2020 , nga i cili është konstatuar se patentë shoferi i lartcekur nuk është prodhuar sipas teknologjisë standarde të prodhimit , ka gabime gramatikore në drejtshkrim dhe se i njëjti është falsifikim i plotë dhe i njëjti është sekuestruar nga ana e Policisë.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjatë pranimi te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë ,pranimi është bere

vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e matjes së dënimit , gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale si në dispozitiv të këtij Aktgjykim ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, sjelljen e tij para kryerjes së veprës penale ka qenë korrekte, qytetar i rëndomtë ,faktin se me parë nuk ka ra ndesh me ligjin. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestarë, premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet ,gjendjen e dobët ekonomike, të cilat rrethana ndikuan që Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burg në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari akuzuarit dhe se ky sanksion do të ndikoj tek të akuzuarit që në të ardhmen të mos kryejnë vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për konfiskimin e patentë shoferi i lëshuar nga Republika e Shqipërisë me nr. serik 903947,të sekuestruar me datën 04.03.20 , është marr konform nenit 115 të KPRK-së .

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale në emër të paushalli gjyqësor në shumë prej 20,00 € është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së,

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.15/21 më datë 16.02.2021.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2021:006282
Datë: 23.02.2021
Numri i dokumentit: 01531315